

## 9 Periudha me nënrenditje

Fjalja e përbërë me nënrenditje është tërësia sintaksore e ndërlidhur organikisht për nga ana kuptimore e gramatikore, e përbërë prej dy a më shumë njësive kallëzuesore, me raporte nënrenditjeje, varësie ndërmjet tyre. Pjesa që shërben si organizuese e fjalisë quhet pjesë kryesore, kurse ajo që plotëson atë e që është e varur ndaj saj, quhet pjesë e nënrenditur ose pjesë e varur.

Një pjesë kryesore mund të ketë dy a më shumë pjesë të varura. Pjesa e varur mund të varet edhe nga një pjesë që është vetë e varur. Pjesa, kryesore ose e varur, prej së cilës varet një pjesë tjetër, quhet *pjesë drejtuese*.

### Në periudhë nënrenditja shprehet me këto mjete:

a) Me *ldhëzat nënrenditëse* dhe me fjalët lidhëse (përemra e ndajfolje lidhore; përemra, ndajfolje e pjesëza pyetëse), të cilat i prijnë pjesës së varur dhe e lidhin atë me pjesën drejtuese. Ishte e qartë që atyre s'u kish rënë në sy një gjë e tillë.

b) Me *intonacionin*, i cili ndryshon nga ai i fjalive bashkërenditëse. Roli i intonacionit është i ndjeshëm sidomos në fjalitë asindetike.

c) Me *fjalët korrelative*, të cilat, duke qenë të pranishme në pjesën drejtuese, paralajmërojnë qenien e domosdoshme të një pjese plotësuese. Si fjalë korrelative dalin përemra dëftorë e të pacaktuar dhe me ndajfolje, p. sh.: Libri është *ai që i zgjeron horizontin njeriut*. E hodhi me *aq forcë, sa u çuditën të gjithë*. Do të vepronin *ashtu* siç propozoi më i riu.

ç) Me *strukturën e pjesës drejtuese*, d.m.th. me mungesën e një gjymtyre të domosdoshme ose me nevojën për të konkretizuar përmbajtjen e një gjymtyre të saj, p.sh.: *Nuk ishte e këshillueshme (ç'?) që i sëmuri të bënte gjithë atë rrugë*.

d) Me bashkëlidhjen e trajtave të foljeve kallëzues, sidomos kur pjesa e nënrenditur nuk prihet nga ndonjë lidhëz a fjalë lidhëse dhe e ka foljen-kallëzues në mënyrën lidhore: Edhe sikur të *donin*, nuk mund të vepronin ndryshe. Në fjalinë me pjesë të nënrenditura kryefjalore e në ndonjë tjetër: 1. *Dihet që Toka rrotullohet rreth Diellit. Ai kishte kohë që nuk kishte shkuar në fshat*.

### Periudha me fjali të varur kryefjalore

Fjali me pjesë të nënrenditur kryefjalore quhet ajo fjali e përbërë që ka një pjesë të varur, e cila kryen ndaj pjesës kryesore dykryegjymtyrëshe një funksion të ngjashëm me atë të kryefjalës, p.sh.: Mikut i ra në sy *se shtëpia ishte ripërtërirë, zbukuruar. Kush s'punon, dheut i rëndon*.

U përgjigjet po atyre pyetjeve të kryefjalës: *kush? cili? ç'?* *çfarë?* Sipas mjetit të lidhjes, fjalia kryefjalore është dy llojesh: a) fjali kryefjalore lidhëzore dhe b) fjali kryefjalore përemërore jokorrelative.

### Fjali kryefjalore lidhëzore

Fjalitë kryefjalore lidhëzore mund të jenë: dëftore, urdhërore, dëshirore dhe pyetëse. P.sh.: Thuhet se *Skënderbeun s'e zinte shpata*. Merret vesh që *rrënjët e kësaj ngjarjeje janë të thella*. I dukej sikur gjithë *pazari i Korçës i kishte sytë tek ai*.

Folje jokalimtare veprorë në vetën e III njëjës: Shpesh ndodh që *s'e kupton as njeriun e afërt*. Rastisi që *në atë udhë të mos kishte asnjë kalimtar*.

Ndërtimet është + emër: *Është fakt* që gjuha është dukuri shoqërore.

Me folje joveprorë në vetën III njëjës që shprehin vullnet, p.sh.: Veçanërisht tani kërkohet (që) të *ngrihet niveli profesional i mësuesve*.

Me emrat të caktuar, p.sh.: Ishte bërë zakon që *nusen ta përcillnin me këngë*. U gjet e nevojshme që *në Napoli të shkonte vetë Skënderbeu*.

### **Fjalitë kryefjalore përemërore**

Si mjete lidhëse të këtij tipi janë përemrat lidhorë të pacaktuar: kush, ç', çka, gjithë sa, gjithë ç', p.sh.: *Kush* duron, trashëgon. *Ç'*fluturon, s'hahet. *Gjithë sa* pe, janë prodhuar këtu.

Nuk dihet *kush e botoi këtë vepër*. Më kujtohet mirë *se cili më pyeti*.

*Që ti je i talentuar*, dihet nga të gjithë. *Kush mbjell*, korr.

### **Periudha me fjali të varur kallëzuesore**

Pjesë e nënrenditur kallëzuesore quhet ajo që kryen funksionin e pjesës emërore të kallëzuesit emëror ose funksionin e përcaktorit kallëzuesor, p.sh.: Tani *ishte besimi* që u përgjigj i pari. Plaku *u shtir* sikur nuk dëgjoi gjë.

Dhe çudia që *se kjo lagje kishte vetëm dy shtëpi*. Ai është *siç ka qenë*. Ti je *ai që ke punuar shumë*. Kur të bëhesh ti sa unë, nuk do të jesh *si je*. S'është puna *ashtu si thua ti*.

Pjesa e varur kallëzuesore bashkohet me kryesoren me lidhëzat *se, që, sikur, kur, tek*; Shqetësimet i dukeshin *sikur ishin me vend*, me përemra të pacaktuar; me përemra lidhorë dhe me ndajfolje lidhore.

Fjali kallëzuesore që kryejnë funksionin e një përcaktori kallëzuesor:

Kur e shikon shoferin që *tregon kujdes* të vjen ta lavdërosh. Ndjeu tëmthas *t'i rrihnin si çekan*.

### **Periudha me fjali të varur kundrinore**

Pjesa e nënrenditur kundrinore kryen një funksion të ngjashëm me atë të kundrinorit, p.sh.: Mitrush Kuteli na tregon *se me ç'mjeshtri mund të përdoret gjuha shqipe*. Deshi të *thoshte diçka*. Thuajti të *vijë menjëherë*. *Ç'të mjellësh*, do të korrësh. Bëri *ç'thanë* shoqet. Çiraku i vogël *ëndërronte të bëhej ustah*.